



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI I TIRANËS  
SENATI AKADEMIK**

Nr.672/2 Prot.

Tiranë më 21.11.2018

**VENDIM**

**Nr. 35, datë 21.11.2018**

***“Mbi miratimin e kursit të trajnimit në fushën e Provave pa Shkatërrim (NDT), pranë Institutit të Fizikës Bërthamore të Zbatuar”***

Bazuar në ligjin Nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” neni 38 pika 3; neni 91 pika 3; në Statutin e UT neni 19 pika 6; në Udhëzimin Nr 25, datë 10.11.2017 “Për regjistrimin e formave të diplomave dhe certifikatave në regjistrin shtetëror të diplomave dhe certifikatave për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor”, neni 4; si dhe në propozimin e Institutit të Fizikës Bërthamore të Zbatuar, Senati Akademik i Universitetit të Tiranës në mbledhjen e tij të datës 21.11.2018,

**VENDOSI:**

- I. Të miratojë propozimin e Institutit të Fizikës Bërthamore të Zbatuar për miratimin e Kursit të trajnimit në fushën e Provave pa Shkatërrim (NDT), në Nivelin 1 dhe Nivelin 2
- II. Të miratojë formën e certifikatës bashkëngjitur këtij vendimi
- III. Ti propozojë për miratim Bordit të Administrimit, planin financiar për secilin kurs
- IV. Ky vendim i përcillet QSHA-së për regjistrimin e formës së certifikatës në Regjistrin Shtetëror të Diplomave dhe Certifikatave për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI**

**PROF.DR. MYNYR KONI**